



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:175448

Datë: 19.08.2024

Numri i dokumentit: 06062523

**C.nr.4182/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, në trupin e përbërë nga gjyqtari Berat Spahiu, kryetar i trupit gjykues, Selami Sylja dhe Nazim Shurdhani, anëtarë të trupit gjykues, në çështjen juridike të propozuesit J.D nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. I.R nga Prishtina dhe propozueses D.D, e lindur K, nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. A.R nga Gjilani, për zgjidhjen e martesës me shkurorezim sipas propozimit të përbashkët, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jopublik të mbajtur më datë 19.08.2024, merr këtë:

**AKTGJYKIM**

I. Martesa e lidhur para personit të autorizuar të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjilan, më dt. 17.06.2016, e evidentuar me numër rendor 203 dhe me numër të referencës 4/2016RM/4001, ndërmjet:

Propozuesit J.D, i lindur më datë 25.02.1993, në Gjilan, ku edhe jeton, nga babai A.D dhe nëna XH.R, me shtetësi kosovar, martesa e parë me radhë, në të cilën martesë nuk ka fëmijë dhe as nuk pritet të ketë dhe propozueses D.D, e lindur K, e lindur më datë 03.08.1995, në Gjilan, ku edhe jeton, nga babai dhe nëna , me shtetësi kosovare, martesa e parë me radhë, në të cilën martesë nuk ka fëmijë dhe as nuk pritet të ketë.

**Zgjidhet me shkurorezim**, në pajtim me dispozitën e nenit 68 paragrafi 1 dhe 2, lidhur me nenin 69 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK).

II. Detyrohet Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, që sipas këtij aktgjykimi të plotfuqishëm, të bëjë ndryshimet përkatëse në Librin Amzë të Kurorëzuarve dhe në Librin Amzë të të Lindurve.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

**A r s y e t i m**

Propozuesit J.D dhe D.D, përmes të autorizuarve të tyre, av. I.R dhe av. A.R, në këtë gjykatë, më datë 21.06.2024, kanë ushtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me shkurorezim.

Në propozim kanë theksuar se propozuesit kanë lidhur martesë më datë 17.06.2016 para personit të autorizuar të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjilan, e cila është regjistruar me numër rendor 203 dhe me numër të referencës 4/2016RM/4001 dhe se pas lidhjes së martesës fillimisht kanë pasur marrëdhënie të mira ndërmjet veti, por që me kalimin e kohës, për shkak të karaktereve të ndryshme, marrëdhëniet ndërmjet tyre janë përkeqësuar, duke e bërë të

padurueshme jetën e përbashkët martesore. Kanë shtuar se kanë bërë përpjekje që t'i rregullojnë raportet e tyre, por pa sukses, andaj bashkërisht kanë vendosur që ta zgjidhin martesën, ashtu që për më tepër se një vit kanë shkëputur bashkësinë e rregullt martesore dhe jetojnë të ndarë nga njëri-tjetri.

Gjykata, në këtë çështje juridike kontestimore më dt. 19.08.2024 ka mbajtur seancë jopublike për shqyrtimin kryesor të çështjes, në të cilën kanë prezantuar i autorizuari i propozuesit, av. I.R dhe i autorizuari i propozueses, av. A.R, të cilët kanë mbetur pranë propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës.

Gjykata, për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit ka administruar këto prova: Certifikata e martesës, me numër rendor 203, lëshuar nga Shërbimi i Gjendjes Civile në Gjilan, në emër të propozuesve J.D dhe D.D.

Meqenëse sipas nenit 84 par. 1 të LFK-së, kur kemi të bëjmë me marrëveshje të përbashkët për shkurorëzim, faktet e paraqitura në propozim nuk hetohen nga ana e gjykatës, atëherë në procedurën e provave gjykata vetëm ka bërë leximin e tyre dhe ka konstatuar se propozuesit kanë lidhur martesë në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjilan, më datë 17.06.2016, e evidentuar me numër rendor 203 dhe me numër të referencës 4/2016RM/4001.

Gjykata ka konstatuar se ndërgjyqësit kanë jetuar në bashkësi martesore për disa vite dhe se fillimisht kanë pasur raporte të mira bashkëshortore, mirëpo me kalimin kohës, për shkak të botëkuptimeve të ndryshme dhe mospajtit të karaktereve, këto raporte janë çrregulluar dhe jeta e përbashkët e bashkëshortëve është bërë e pamundur, me ç'rast për më tepër se një vit jetojnë të ndarë. Po ashtu, gjykata ka konstatuar se propozuesit nuk kanë fëmijë të përbashkët nga kjo bashkësi martesore dhe as nuk pritet të kenë.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 68 paragrafi 1 dhe 2, lidhur me nenin 69 paragrafi 1 dhe 2 të LFK-së, e aprovoi propozimin e propozuesve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, për shkak të çrregullimit serioz dhe të vazhdueshëm të raporteve bashkëshortore, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 69 paragrafi 1 dhe 2 i LFK-së, meqë dispozita përkatëse ligjore shprehimisht ka paraparë se *“(1) Bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, ose kur për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pa kthyeshme. (2) Shkaqet e shkurorëzimit janë mes tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme.”*

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, ashtu që detyrohet Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan që të bëjë ndryshimin sipas këtij aktgjykimi të plotfuqishëm në Librin Amzë të Kurorëzuarve dhe në Librin Amzë të të Lindurve.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, konform nenit 452.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Nga të cekurat më lart e konform neneve 68 par. 1 dhe 2 dhe 69 par. 1 dhe 2 të LFK-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2024:175448, 19.08.2024**

Kryetari i trupit gjykues  
Berat Spahiu

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Konform nenit 87 të LFK-së, ankesa është e lejueshme vetëm për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ose për arsye se propozimi është dhënë në lajthim apo nën ndikimin e mashtrimit dhe kërcënimit.